



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsioni, duke vepruar në rastin e formuar pas kërkesës së paraqitur nga parashtruesi i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK), në seancën e 84-të të mbajtur më 31.02.2023 ka miratuar si në vijim.

VENDIM

Denoncimi me numër 12 - 5632/1 të datës 13.06.2022 me pretendime për dyshime për parregullsi dhe mosrespektimi i dispozitave ligjore në ngritjen e njërive të projektit, HIDHET POSHT.

KSHPK-ja konstatoi se, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka elemente për veprim kompetent për këtë çështje, sepse në këtë rast të veçantë nuk ka pretendime apo indikacione të qarta për veprime të paligjshme apo të palejueshme të zyrtarëve në ushtrimin e kompetencave publike dhe detyrës zyrtare.

Lënda me numër 12 - 5632/1 të datës 13.06.2022 të mbyllet dhe të arkivohet.

Ky vendim në formë të depersonalizuar do të publikohet në faqen e internetit të KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi

Arsyetim

Më datë 14.02.2022, një parashtrues i panjohur ka dorëzuar një denoncim të regjistruar me numër 12-5632/1 datë 13.06.2022, pas së cilës është ngritur rasti me pretendimet për parregullsi dhe mos respektim të dispozitave ligjore gjatë krijimit të njërive të projektit, d.m.th që formohen jashtë organeve të administratës shtetërore dhe sipas nenit 11 të Dekretit mbi parimet e organizimit të brendshëm të organeve të administratës shtetërore, njësitë e projektit u formuan si departamente në strukturën e ministrive, me paga sipas ligjit për nëpunësit administrativë. Sipas parashtruesit, njësitë e projektit janë jashtë sistemit, me paga nga 2-3000 euro dhe të gjitha ministrinë kanë pasur 2-3 njësi të projekteve të formuara mbi këtë parim.

Ndaj denoncimit, në adresën elektronike të KSHPK-së është dorëzuar një shtojcë e datës 21.06.2022, e regjistruar me numër 12 - 5632/2 datë 15.07.2022, në të cilën dyshohet për korrupsion në arsimin e lartë, d.m.th. që punonjësit e --- -- jepnin mësim në universitete private dhe shtetërore. Lidhur me shtesën, nga KSHPK më 27.06.2023, është kërkuar që të parashtrihen pretendime më konkrete dhe më të sakta dhe të bashkëngjitet dokumentacioni lidhur me pretendimet në fjalë, pas së cilës është përgjigjur se parashtruesi nuk ka prova me shkrim për të denoncuarin.

Gjatë shqyrtimit të denoncimit anonim të dorëzuar dhe shtimit në të, KSHPK-ja thekson se në rastin konkret nuk ka pretendime apo indikacione të qarta për veprime të paligjshme apo të palejueshme të zyrtarëve në ushtrimin e pushteteve publike dhe detyrave zyrtare dhe nga ana e parashtruesit, i cili paraqitet si anonim, nuk janë siguruar informacionet shtesë të kërkuara dhe dokumentacioni dëshmuar për pretendimet në denoncim.

Duke pasur parasysh të theksuarën sa më sipër, KSHPK-ja vlerësoi se nuk kishte elemente për veprimin e duhur të KSHPK-së për këtë çështje dhe vendosi si në dispozitën e kësaj vendimi.

**KOMISIONI SHETËTORË
PËR PARANDAËIMIN E KORRUPSIONIT
Nënkryetare,
Katica Nikolovska**

Përgatiti: J.C,
miratoi : Mr. Sh.S, Anëtar i KSHPK-së